



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

FOL

RAPORT ANALITIK

DILEMAT PRAKTIKO-JURIDIKE TË (PA)ZBATUESHMËRISË SË SINJALIZIMIT NË SEKTORIN PRIVAT

Janar, 2024

TITULLI: Dilemat praktiko-juridike të (pa)zbatueshmërisë së sinjalizimit në sektorin privat

AUTOR: Lëvizja FOL

VITI I BOTIMIT: Janar, 2024

PUBLIKUAR NGA: Lëvizja FOL

WEBSITE: www.levizjafol.org

ADRESA: Andrea Gropa nr.35, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Të drejtat e autorit © 2024. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky raport është hartuar nga Lëvizja FOL me mbështetjen e USAID – Integriteti Komunal i Kosovës. Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

PËRMBAJTJA:

1. LISTA E SHKURTESAVE.....	4
2. HYRJE	5
3. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	6
4. KORNIZA LIGJORE E SINJALIZIMIT NË SEKTORIN PRIVAT NË VENDET E BASHKIMIT EVROPIAN DHE NË VENDET E RAJONIT	8
3.1 SINJALIZIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN.....	8
3.2 SINJALIZIMI NË VENDET E RAJONIT	9
5. QËLLIMI I LIGJIT PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE I REPUBLIKËS SË KOSOVËS.....	10
6. ANALIZIMI I DISPOZITAVE TË SINJALIZIMIT NË SEKTORIN PRIVAT –	12
7. KONKLUZION	16
8. REKOMANDIME.....	17

1. LISTA E SHKURTESAVE

LMS – Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve

LMI – Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve

APK - Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit

IP - Inspektorati i Punës

MD – Ministria e Drejtësisë

ILDKPKI - Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

LMD - Ligji për Mbrojtjen e Denoncuesve

RMV – Republika e Maqedonisë së Veriut

2. HYRJE

Sinjalizimi si mekanizëm siguron një klimë të përshtatshme për zbulimin e veprimeve të paligjshme dhe rrit ndërgjegjësimin e qytetarëve për përgjegjësinë shoqërore. Përmes krijimit të një relacioni të fortë ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve shtetërore, ky mekanizëm kontribuon në rritjen e integritetit institucional dhe në sundimin e ligjit. Përkatësisht, duke zbuluar informacione rreth keqpërdorimeve në ambientet e punës, sinjalizuesit ndihmojnë në uljen e veprimeve që e dëmtojnë interesin publik, sigurinë, integritetin financiar dhe sundimin e ligjit. Rrjedhimisht, personat që raportojnë shkeljet apo keqpërdorimet, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, luajnë një rol kyç në shpërndarjen e informacioneve të rëndësishme dhe ngritjen e vetëdijes së publikut rreth abuzimeve të mundshme.

Ndonëse në esencë, sinjalizimi ka të bëjë me angazhimin publik për të mirën e përgjithshme, ekziston perceptimi negativ në shoqëri ndaj sinjalizuesve, të cilët shpesh marrin epitetin e spiunëve. Prandaj ka qenë shumë e rëndësishme që korniza ligjore që e rregullon sinjalizimin të definojë qartë termat, në mënyrë që të inkurajohet sinjalizimi dhe të pranohet në shoqëri si akt i cili ndikon në uljen e aktiviteteve korruptive.

Sinjalizimi në sektorin publik paraqet një mundësi për të punësuarit në institucione të shtetit, që në mënyrë ligjore të paraqesin deri tek eprorët apo institucionet kompetente dyshimet e tyre të bazuara mbi keqpërdorimet eventuale tek të cilat kanë hasur gjatë punës së tyre. Zyrtarët shtetëror paraqesin hallkën më të rëndësishme të konstelacionit të institucioneve shtetërore, duke qenë pararojë e çdo keqpërdorimi apo keq shfrytëzimi të resurseve dhe autorizimeve ligjore.

Sinjalizimi në sektorin privat, në veçanti, shërben si një mjet kyç për të identifikuar, parandaluar dhe luftuar korrupsionin dhe shkeljet e tjera etike dhe ligjore brenda subjekteve të sektorit privat. Sinjalizimi gjithashtu përmirëson kulturën organizative të subjekteve private, duke nxitur një mjedis ku përgjegjshmëria dhe integriteti janë vlera themelore. Raportimet nga sinjalizimi mund të shërbejnë si burim i vlefshëm i informacionit për përmirësimin e proceseve dhe zhvillimin e inovacioneve brenda organizatave.

Prandaj, krijimi i strukturave të qarta për raportim të shkeljeve, keqpërdorimeve apo sjelljeve jo etike, si dhe sigurimi që të punësuarit të janë të njoftuar me këto struktura, paraqet një domosdoshmëri për zbatimin e duhur të ligjit. Rrjedhimisht, është i domosdoshëm përkushtimi në qartësimin e dispozitave ligjore për hapat e raportimit dhe qartësimi i institucioneve kompetente për të bërë sinjalizimin në këtë sektor, për të siguruar zbatimin e këtij ligji, si një hap jetik për të ngritur integritetin, transparencën, konkurrencën në treg. Parandalimi i keqpërdorimeve eventuale në sektorin privat ka impakt tepër të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin financiar të një vendi, andaj fuqizimi dhe ngritja e vetëdijes së punëtorëve të sektorit privat për këtë mekanizëm duhet të shihet si domosdoshmëri.

Ky raport analitik ka për qëllim të ngrit dilemën juridike mbi nivelin e zbatimit të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve për sektorin privat, duke përfshirë një vlerësim të aspektit praktik dhe juridik të këtyre dispozitave. Gjithashtu, kjo analizë synon të identifikoj mangësitë praktike në zbatimin e këtyre dispozitave duke synuar nxjerrjen e rekomandimeve për zbatimin efektiv të ligjit dhe shmangien e paqartësive për të punësuarit e sektorit privat në lidhje me hapat e raportimit.

3. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ky raport analitik synon të analizoj dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në sektorin privat në Kosovë, duke analizuar edhe ligjet e disa vendeve të rajonit, si dhe rregullativën e sinjalizimit në sektorin privat në Bashkimin Evropian. Synimi i kësaj analize është të ofrojë një bazë solide për kontekstin e Kosovës, duke përmirësuar kuptimin dhe implementimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në këtë sektor dhe duke promovuar një mjedis më të përshtatshëm për sinjalizuesit në sektorin privat në Kosovë.

Raporti përfshinë edhe analizën krahasimore me ligjin e Republikës së Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut, si vende që kanë praktika, zgjidhje ligjore të përafërta dhe sistem juridik të ngjashëm me atë të Kosovës. Ky krahasim do të ndihmojë në identifikimin e praktikave të mira dhe në përcaktimin e ndryshimeve potenciale që mund të përmirësojnë klimën e sinjalizimit në sektorin privat në Kosovë.

Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve i Kosovës ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2018, ndërsa dispozitat për sektorin privat janë fuqizuar një vit më vonë (dhjetor 2019). Ky ligj i obligon të gjithë punëdhënësit publik që kanë më shumë se 15 të punësuar dhe punëdhënësit privat që kanë më shumë se 50 të punësuar të caktojnë zyrtarët përgjegjës për sinjalizimin.

Mirëpo, ndonëse ligji është konform standardeve të Bashkimit Evropian, gjetjet e Lëvizjes FOL dëshmojnë se zbatimi i tij në sektorin privat ka hasur në sfida.

Një problem kyç në zbatimin e tij është mungesa e qartësisë në rregullimin ligjor, e sidomos në përcaktimin e institucioneve kompetente për trajtimin e raporteve të sinjalizimit në sektorin privat. Sipas dispozitave të ligjit, subjektet e sektorit privat për të bërë sinjalizim të jashtëm duhet të raportojnë tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë. Pra tek institucionet e ndryshme, të kategorizuara sipas llojit të rastit për të cilin bëhet sinjalizimi, por pa u specifikuar se cilat janë këto institucione.

Në këtë mënyrë, pa udhëzime të qarta se ku duhet të raportojnë, subjektet e sektorit privat do të kenë vështirësi në identifikimin e institucioneve kompetente për t'u drejtuar me informacionet e tyre në lidhje me shkeljet dhe keqpërdorimet eventuale. Rrjedhimisht, FOL vlerëson se është i rëndësishme një vlerësim ex-post i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, duke hapur rrugën për plotësimin ose ndryshimin e tij. Ky vlerësim do të adresojë nevojën për specifikimin e autoriteteve kompetente që do të pranojnë dhe shqyrtojnë raportimet nga subjektet e sektorit privat. Qëllimi i këtij vlerësimi është sigurimi i implementimit të duhur të ligjit në praktikë, përfshirë dhe përmirësimin e kuptimit dhe zbatimit të tij nga ana e bizneseve në sektorin privat të Kosovës.

Në anën tjetër, ligji u'a kanë vënë në barrë subjekteve private t'a rregullojnë vet procedurën e pranimit dhe trajtimit të rasteve të sinjalizimit, në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Mirëpo, ligji nuk ka paraparë obligimin e ndonjë institucioni për të hartuar udhëzime për mënyrën e draftimit të këtyre akteve nga ana e subjekteve private.

Tutje, nëse analizojmë raportet vjetore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, mund të shohim se vetëm një përqindje e ulët e subjekteve private kanë paraqitur raporte vjetore të sinjalizimit për periudhën 2020-2022, obligim që i'u është dhënë më Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Pra, vetëm 5 biznese nga

totali prej 721 biznese me mbi 50 të punësuar që operojnë aktualisht kanë paraqitur raporte vjetore për numrin e sinjalizimeve për vitin përkatës. Ky numër i ulët i bizneseve reflekton mungesën e përgjegjësisë nga sektori privat, ndërsa nga ana tjetër, mund të interpretohet si mungesë e informacionit të subjekteve të këtij sektori për detyrimet që u`a njuh ligji.

Në vazhdim, sipas ligjit, Inspektorati i Punës obligohet të filloj procedurat sipas ligjit për Kundërvajtje ndaj punëdhënësve privat dhe zyrtarëve përgjegjës të këtij sektori të cilët nuk i kanë përmbushur obligimet e ligjit jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes së këtyre dispozitave në fuqi. Mirëpo, gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të këtij institucioni, si dhe në raportet vjetore të tij, LMS nuk figuron askund në listën e ligjeve për të cilat ky institucion e bën mbikëqyrjen apo inspektimin e zbatimit.

Dihet se mungesa e kapaciteteve të këtij institucioni për të mbikëqyrë zbatimin e këtij mekanizmi në sektorin privat është shkaku kryesor për mungesën e zbatimit të këtyre dispozitave, prandaj ngritja e kapaciteteve të këtij institucioni duhet të shihet si domosdoshmëri për të jetësuar zbatimin e sinjalizimit në sektorin privat. Ky aspekt thelbësor përcakton nevojën e një përmirësimi të strukturave dhe kapaciteteve të Inspektoratit të Punës në mënyrë që të mund të përballojë dhe mbikëqyrë me efikasitet zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në sektorin privat.

4. KORNIZA LIGJORE E SINJALIZIMIT NË SEKTORIN PRIVAT NË VENDET E BASHKIMIT EVROPIAN DHE NË VENDET E RAJONIT

3.1 SINJALIZIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN

Rregullimi ligjor i sinjalizimit në kuadër të Bashkimit Evropian përfshinë *Direktivën 2019/1937 për mbrojtjen e personave të cilët raportojnë shkelje*, të miratuar nga Parlamenti Evropian me 23 tetor 2019. Lidhur me sinjalizimin në sektorin privat, me nenin 8 të kësaj direktive obligohen shtetet anëtare që të sigurojnë se personat juridik privat që kanë pesëdhjetë (50) e më shumë të punësuar të krijojnë kanale dhe procedura për raportim të brendshëm të informacioneve mbi shkeljet që ndodhin në këto institucione.¹

Kjo direktivë paraqet përpjekjen për të siguruar një ambient më të favorshëm për identifikimin dhe raportimin e shkeljeve në ambientin e punës dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Pra kjo direktivë parasheh rregulla minimale të cilat shtetet anëtare duhet t'i inkorporojnë në legjislacionin e tyre, dhe ato mund t'i zgjerojnë këto rregulla për të i'u përshtatur kontekstit dhe nevojave të tyre kombëtare.

Kjo direktivë parasheh se rregullat për identifikimin dhe raportimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve janë të vlefshme edhe për sektorin privat, ashtu sikurse për sektorin publik. Mirëpo, Direktiva përcakton në mënyrë specifike se subjektet e sektorit privat që kanë më shumë se 50 të punësuar janë të obliguara të mundësojnë sinjalizimin brenda organizatës në mënyrë që punëtorët të raportojnë shkeljet eventuale.

Gjithashtu, direktiva parasheh se, me kusht që të sigurohet konfidencialiteti i personit raportues, çdo subjekti privat apo publik i takon të përcaktoj llojin e kanaleve të raportimit që do të krijohen, me kusht që këto kanale të ju krijojnë mundësi personave të raportojnë me shkrim dhe të dërgojnë raporte me postë, apo përmes ndonjë platforme në internet.²

Neni 56 i direktivës parasheh së zgjedhja e personave apo departamenteve më të përshtatshme brenda një personi juridik në sektorin privat i caktuar si kompetent për pranimin dhe ndjekjen e raporteve varet nga struktura e subjektit, por, në çdo rast, funksioni i tyre duhet të jetë i tillë që të sigurojë pavarësinë dhe mungesën e konfliktit të interesit.

Sipas kësaj direktive, procedurat për raportim dhe përcjellje të shkeljeve, si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat, duhet të garantojnë konfidencialitet të personit raportues, të caktohet një person ose departament kompetent për dërgimin e raporteve, të siguroj informacion të qartë dhe lehtësisht të arritshëm në lidhje me procedurat e raportimit, si dhe të siguroj përgjigje për personin raportues brenda një afati të arsyeshëm, që nuk mund të kaloj 3 muaj pas raportimit.

¹ Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, *Direktiva (EU) 2019/1937 për mbrojtjen e personave të cilët raportojnë shkeljet*, neni 48.

² Po aty, neni 53.

Pas sjelljes së kësaj direktive, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (si dhe shtetet që janë në proces të anëtarësimit) kanë qenë të obliguara që të sjellin akte ligjore, përkatësisht t'i përshtatin ligjet ekzistuese me frymën dhe qëllimin e kësaj direktive.

3.2 SINJALIZIMI NË VENDET E RAJONIT

Në qershor të vitit 2016, Republika e Shqipërisë kishte miratuar Ligjin nr. 60/2016 për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i cili u ndryshua/plotësua në dhjetor të vitit 2020 me Ligjin nr. 150/2020. Ky ligj përcakton rregullat për sinjalizimin e një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni nga sinjalizuesit në sektorin publik e privat, mekanizmat për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe detyrimet e autoriteteve publike e të subjekteve private në lidhje me sinjalizimin.³

Për dallim nga LMS i Kosovës, Ligji për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve i Republikës së Shqipërisë, në nenin 10 të tij, ka paraparë se dispozitat e këtij ligji vlejnë për çdo institucion publik që ka më shumë se 80 të punësuar, dhe çdo institucion privat që ka më shumë se 100 të punësuar. Pra ligji i Republikës së Shqipërisë, edhe pse i ndryshuar/plotësuar vonë, nuk është harmonizuar ende me Direktivën 2019/1937 të Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, Ligji për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve i Republikës së Shqipërisë, në paragrafin 3 të nenit 10 të tij e obligon Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) që të përcaktoj me udhëzim strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimin e punonjësve për shqyrtim të hetimit administrativ të sinjalizimit të subjekteve private. Sipas këtij ligji, çdo organizatë publike ose private, sipas udhëzimeve të ILDKPKI- së duhet të miratoj rregullore të brendshme të posaçme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrative të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit.

Ndërkaq Republika e Maqedonisë së Veriut në nëntor të vitit 2015 kishte miratuar Ligjin nr. 196/15 për Mbrojtjen e Denoncuesve⁴ (LMD) me të cilin rregullohet denoncimi i mbrojtur, të drejtat e denoncuesve, si dhe veprimi dhe detyrat e institucioneve, respektivisht personave juridik, në lidhje me denoncimin e mbrojtur dhe sigurimin e mbrojtjes së denoncuesve.

Në LMD të R.M.V. - së është përcaktuar se sinjalizimi i brendshëm në sektorin privat rregullohet me akt të brendshëm. Mirëpo, për dallim nga ligji jonë, ligji i RMV-së gjithashtu e obligon Ministrinë e Drejtësisë për hartimin e udhëzimeve për miratimin e akteve të brendshme nga subjektet e sektorit privat.⁵

Ndryshe nga LMS i Republikës së Kosovës, ligji i Republikës së Shqipërisë dhe ai i Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë paraparë institucione të njëjta për raportim, si për institucionet publike ashtu edhe për ato private.

³ Kuvendi i Republikës Së Shqipërisë, Ligji nr. 60/2016 për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i ndryshuar me ligjin nr. 150/2020, datë 17.12.2020.

⁴ Ligji për Mbrojtjen e Denoncuesve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.196/15, 35/18 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.257/20.

⁵ Po aty, neni 4.

5. QËLLIMI I LIGJIT PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Deri në vitin 2018 në Kosovë ka ekzistuar Ligji nr. 04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve (LMI), i cili kishte hyrë në fuqi në shtator të vitit 2011, dhe si i tillë për herë të parë e rregullonte çështjen e raportimit të veprimeve kundërligjore, për tu zëvendësuar pastaj me *Ligjin nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve* (LMS). LMI, në 9 nene të tij, kishte për qëllim “*krijimin e bazës ligjore për çytjen e zyrtarëve për paraqitjen e veprimeve kundërligjore*”.⁶

LMS, i cili ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2018, paraqet një hallkë të rëndësishme të harmonizimit të ligjeve nacionale me politikën dhe qëllimet e Bashkimit Evropian në drejtim të rregullimit juridik të çështjes së sinjalizimit.

LMS, me 32 nenet të cilat i ka në përbërje, përcakton rregullat për sinjalizimin, procedurën e sinjalizimit, të drejtat dhe mbrojtjen e sinjalizuesve dhe detyrimet e institucioneve publike dhe **subjekteve private** në lidhje me sinjalizimin. Përveç raportimit të shkeljeve nga institucionet e sektorit publik, ky ligj rëndësi i kushton edhe sektorit privat, dispozitat e të cilit kanë filluar të zbatohen një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji (në dhjetor 2019).

Në kuptim të këtij ligji, sinjalizues quhet çdo person i cili raporton ose shpalos informacione për një kërcënim ose cenim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës në sektorin publik ose privat dhe çdo sinjalizues ka të drejtën e mbrojtjes së identitetit të tij gjatë procesit të sinjalizimit; ruajtjen e fshehtësisë së burimit të informacionit të sinjalizuar, si dhe mbrojtjes kundër veprimeve të dëmshme. Këto të drejta i janë garantuar sinjalizuesit përmes këtij ligji, gjatë kohëzgjatjes së hetimit, pas procedurës së hetimit, si dhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës. Gjithashtu, sinjalizuesi apo personi që shpalos informata nuk mund të jetë subjekt i përgjegjësisë penale ose civile apo procedurave disiplinore, për shkak të sinjalizimit të tij.

Ligji përcakton se, punëdhënësit e subjekteve publike me më shumë se 15 të punësuar, dhe punëdhënësit e institucioneve private me më shumë se 50 të punësuar, janë të obliguar të caktojnë zyrtarët përgjegjës për sinjalizimin për të pranuar dhe trajtuar rastet e sinjalizimit.

Sipas nenit 13 të këtij ligji, ekziston sinjalizimi i brendshëm, i jashtëm dhe publik. Në rastin e sinjalizimit të brendshëm, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, sipas këtij neni, informacioni raportohet tek punëdhënësi (personi përgjegjës i punëdhënësit). Punëdhënësi sipas dispozitave të këtij ligji nënkuptohet çdo institucion publik dhe subjekt privat.

Ky ligj i ka dhënë mundësi sinjalizuesit që të raportojë edhe direkt tek drejtuesi i punëdhënësit (drejtuesi i institucionit publik apo privat), në rast se punëdhënësi nuk ka caktuar zyrtar përgjegjës, në rast se punëdhënësi nuk ka përcaktuar dhe publikuar procedura të brendshme për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve, në rast se sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës është ose mund të përfshihet në praktikën e dyshuar të sinjalizimit, në rast se sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës për shkak të çfarëdo marrëdhënie ose shoqërie me një person mund të jetë i përfshirë në

⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve, neni 1.

çështjen e pretenduar në sinjalizim, nëse nuk është personi i përshtatshëm për t'u informuar me sinjalizimin, si dhe në rast se sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se procedurat e brendshme të sinjalizimit nuk janë efektive.

Sipas dispozitave përfundimtare të këtij ligji, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) për sektorin publik dhe Inspektorati i Punës (IP) për sektorin privat obligohen të fillojnë procedurat sipas ligjit për kundërvajtje ndaj punëdhënësve dhe zyrtarëve përgjegjës të cilët nuk i kanë përmbushur obligimet sipas këtij ligji.

Sipas paragrafit 6 të nenit 17 të këtij ligji, subjektet private obligohen që të krijojnë akte të brendshme për të përcaktuar procedurën e pranimit dhe trajtimit të rasteve të sinjalizimit. Kjo nënkupton se institucionet e sektorit privat duhet të sjellin një akt të brendshëm i cili në kuadër të kompanisë private do të garantonte të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga LMS, përkatësisht do të përcaktonte personin përgjegjës për pranimin e sinjalizimit, procedurën e sinjalizimit, si dhe trajtimin e mëtutjeshëm të rastit.

Për të përcaktuar rregullat dhe procedurën e trajtimit të rasteve të sinjalizimit, LMS në nenin 17, par. 5 të tij, kishte përcaktuar obligimin e qeverisë që të nxjerrë akt nënligjor për të përcaktuar procedurën e pranimit dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit. Në lidhje me nenin 30, par. 1 të LMS-së, afati i përcaktuar për nxjerrjen e këtij akti nënligjor ishte përcaktuar të jetë 6 muaj pas hyrjes në fuqi të LMS-së.

Dokumenti⁷ i cili duhej të nxirrej në korrik të vitit 2019, ishte miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me 6 maj 2021, pra 1 vit e disa muaj me vonesë.

Në këtë dokument, ishte përcaktuar se në afat prej 6 muajsh pas hyrjes në fuqi të tij, Ministria e Drejtësisë (MD) dhe APK të hartojnë:

- *Udhëzuesin për mbrojtjen që ju ofrohet personave që dorëzojnë raportimet në interes publik, obligimet e punëdhënësve për të mbrojtur sinjalizuesit nga aktet e dëmshme dhe të drejtën e sinjalizuesve për mbrojtje gjyqësore;*
- *Udhëzuesin për mënyrën e kryerjes së hetimit administrativ.*

Udhëzuesi për mënyrën e kryerjes së hetimit administrativ është miratuar nga Ministria e Drejtësisë, me Vendimin Nr. 158/2023 me datë 18.07.2023.⁸ Ndërsa *Udhëzuesi për Mbrojtjen e Personave që Raportojnë në Interes Publik, Detyrimet e Punëdhënësve për Mbrojtjen e Sinjalizuesve nga Aktet e Dëmshme dhe të Drejtat e Sinjalizuesve për Mbrojtje Gjyqësore*⁹ është miratuar nga Ministria e Drejtësisë me Vendimin nr. 179/2023 me datë 19 shtator 2023.

⁷ Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregullorja (QRK) - nr. 03/2021 për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit.

⁸ Ministria e Drejtësisë, Udhëzues për Mënyrën e Kryerjes së Hetimit Administrativ.

⁹ Ministria e Drejtësisë, Udhëzues për Mbrojtjen e Personave që Raportojnë në Interes Publik, Detyrimet e Punëdhënësve për Mbrojtjen e Sinjalizuesve nga Aktet e Dëmshme dhe të Drejtat e Sinjalizuesve për Mbrojtje Gjyqësore.

Këto akte, edhe pse të nxjerra me vonesë, paraqesin një hap të madh në drejtim të qartësisimit të dispozitave ligjore sa i përket mënyrës së kryerjes së hetimit administrativ, si dhe për mbrojtjen që ju ofrohet sinjalizuesve nga aktet e dëmshme.

6. ANALIZIMI I DISPOZITAVE TË SINJALIZIMIT NË SEKTORIN PRIVAT –

SFIDAT E ZBATIMIT TË KËTYRE DISPOZITAVE NË PRAKTIKË

LMS ka për qëllim rregullimin e sinjalizimit në tërësi, duke garantuar mbrojtje për të gjithë sinjalizuesit, pavarësisht nëse sinjalizimi është bërë në sektorin publik apo privat.

Është e qartë se, përveç se është obligim ligjor, është në interes të subjekteve private që të zhvillojnë një sistem efektiv të sinjalizimit të bazuar në parime të shëndosha. Ky sistem jo vetëm që do të forconte integritetin e subjektit juridik, por gjithashtu do të zvogëlonte rreziqet për korrupsion, do të mbronte reputacionin e subjektit juridik, do të kontribuonte në ndërtimin e mirëbesimit në komunitet, e me këtë padyshim se do të ndikonte pozitivisht edhe në konkurrencën e tregut.

Megjithatë, edhe pse ky ligj sinjalizimin në sektorin publik e rregullon në mënyrë relativisht të çartë, për sinjalizimin në sektorin privat ka lënë mjaft paqartësi. Këto paqartësi kanë të bëjnë me mungesën e përcaktimit të saktë të institucioneve kompetente për të raportuar, që shpie në një nivel të konsiderueshëm të vështirësive në identifikimin e këtyre institucioneve dhe mungesës koherente në implementimin e këtij mekanizmi në mjediset e subjekteve private. Kjo dhe çështje të tjera janë shtjelluar në pjesën vijuese të raportit.

Duke qenë se objekt trajtimi i këtij raporti është sinjalizimi në sektorin privat, në tekstin e mëposhtëm janë analizuar vetëm dispozitat të cilat i referohen në veçanti sektorit privat.

Fillimisht, sektori privat përmendet në përcaktimin e numrit të të punësuarve për të cilët vlen ky ligj, përkatësisht në par. 1 të nenit 17, ku thuhet se:

“Punëdhënësi publik i cili ka më shumë se pesëmbëdhjetë (15) të punësuar, dhe punëdhënësi privat, i cili ka më shumë se pesëdhjetë (50) të punësuar janë të obliguar të caktojnë zyrtarin përgjegjës”.

Pra kjo dispozitë përcakton obligimin e punëdhënësve që kanë numrin përkatës të të punësuarve, pra 15 të punësuar për sektorin publik dhe 50 të punësuar për sektorin privat, që të caktojnë kanale të raportimit të brendshëm, përkatësisht të caktojnë personat përgjegjës për sinjalizim, në mënyrë që të shërbejnë si cak ku duhet të raportohet informacioni.

Kjo zgjidhje ligjore e paraparë në LMS është në harmoni me *Direktivën 2019/1937 për mbrojtjen e personave të cilët raportojnë shkelje, ku në nenin 8 të saj është përcaktuar se subjektet private që kanë më shumë se 50 të punësuar, duhet të krijojnë kanale dhe procedura për raportim të brendshëm të informacioneve.*

Par. 6 i nenit 17 të LMS-së ka paraparë se:

“Subjektet private përcaktojnë procedurën për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit me akt të brendshëm në pajtim me këtë ligj”.

Kjo dispozitë nënkupton se, ligji u'a ka vënë në barrë subjekteve private t'a rregullojnë vet procedurën e pranimit dhe trajtimit të rasteve të sinjalizimit, në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Mirëpo, ligji nuk ka paraparë obligimin e ndonjë institucioni për të hartuar udhëzime për mënyrën e draftimit të këtyre akteve nga ana e subjekteve private.

Në nenin 19 të LMS-së rregullohet çështja e sinjalizimit të jashtëm në sektorin privat. Ky nen parasheh se:

- ***“Në lidhje me sinjalizimin në sektorin privat tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë zbatohet përshtatshmërisht procedura e paraparë në nenin 16 të këtij ligji.”***

Sipas kësaj dispozite, subjektet e sektorit privat për të bërë sinjalizim të jashtëm duhet të ndjekin procedurën e njëjtë me sinjalizimin e brendshëm për subjektet e sektorit publik¹⁰. Ky raportim i jashtëm, sipas këtij neni, duhet të bëhet tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë.

Sinjalizimi i jashtëm për sektorin privat raportohet tek institucionet që shërbejnë si rregullatorë përgjegjës në fushat e ndryshme, si në vijim: Administrata Tatimore e Kosovës; Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve; Oda e Avokatëve; Oda e Mjekëve; Banka Qendrore; Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik; Inspektoratet; Divizionet apo Departamentet e ndryshme në kuadër të ministrive.¹¹

Pra, rolin që e ka Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, si institucion ku duhet të raportojnë subjektet e sektorit publik për të bërë sinjalizim të jashtëm dhe që përfshin shqyrtimin e rasteve të sinjalizimit që bien në fushëveprimin e këtij institucioni, në sektorin privat këtë rol e kanë rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë. Pra institucionet e ndryshme, të kategorizuara sipas llojit të rastit për të cilin bëhet sinjalizimi.

Rrjedhimisht, ligji nuk ofron udhëzime të tjera se ku duhet të drejtohen sinjalizuesit e sektorit privat për të sinjalizuar shkeljet apo keqpërdorimet, duke lënë paqartësi për të kuptuar se kush janë institucionet kompetente për të bërë sinjalizim të jashtëm dhe duke e lënë ligjin ta pa zbatueshëm për këtë sektor. Prandaj, pa udhëzime të qarta se ku duhet të raportojnë, sinjalizuesit do të kenë vështirësi në identifikimin e institucioneve kompetente për t'u drejtuar me informacionet e tyre në lidhje me shkeljet dhe keqpërdorimet eventuale.

Ndryshe nga ligji jonë, Ligji për Mbrojtjen e Denoncuesve i Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk bën dallim sa i përket institucioneve ku duhet të bëhet raportimi i shkeljeve. Pra institucionet kompetente ku duhet raportuar për sinjalizim të jashtëm, janë të njëjta, si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat. Ky ligj, si institucione kompetente ku duhet të bëhet sinjalizimi i jashtëm, si për sektorin privat ashtu edhe për atë publik, i ka paraparë këto institucione: *Ministrinë e Punëve të Brendshme; Prokurorinë publike*

¹⁰ Neni 16 i LMS-së përcakton procedurën e sinjalizimit të brendshëm për sektorin publik.

¹¹ Instituti Demokratik i Kosovës, Komentari i Ligjit nr. 065/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, 2021, Prishtinë.

*përkatëse; Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit; Avokatin e Popullit dhe institucionet tjera kompetente.*¹²

Kjo zgjidhje ligjore për raportim për të dy sektorët, ka për qëllim që të siguroj ndërthurje dhe standarde të njëjta për raportim, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe përgjegjësisë së njëjtë të të gjitha institucioneve në luftën kundër korrupsionit.

Njëjtë ka vendosur edhe ligjvënësi i Republikës së Shqipërisë, ku secili institucion që ka numrin e përkatës të të punësuarve, publik apo privat, duhet të krijoj një zyrë përgjegjëse për të sinjalizuar. Ndërkaq për sinjalizim të jashtëm, për të dy sektorët, sinjalizimi bëhet tek Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.¹³

Në këtë drejtim, FOL konsideron se është i nevojshëm vlerësimi ex-post i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në mënyrë që të hapet rruga drejt plotësim/ndryshimit të tij, me qëllim të specifikimit të autoriteteve kompetente që do të pranojnë dhe shqyrtojnë raportimet nga ana e subjekteve të sektorit privat, në mënyrë që të sigurohet implementimi i duhur i ligjit në praktikë.

Vlerësimi ex-post i legjislacionit paraqet një mjet të rregullimit më të mirë të akteve juridike. Në këtë kuptim, duke marrë parasysh gjendjen faktike të “mos zbatimit efektiv” të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, më saktësisht të atyre që kanë të bëjnë me sektorin privat, mund të themi se vlerësimi ex-post i dispozitave ligjore paraqitet si domosdoshmëri. Vlerësimi ex-post i dispozitave të këtij ligji do t’i jepte përgjigje pyetjeve mbi nivelin e zbatimit efektiv të dispozitave ligjore, nivelin e efektshmërisë së miratimit të ligjit, përfitimet e sjelljes së tij, si dhe nëse shpenzimet e institucioneve shtetërore do të arsyetojnë zbatimin e ligjit.

Neni 27 i ligjit ka paraparë dispozitat kundërvajtëse për institucionet publike dhe private, apo autoritetet kompetente përkatëse, në rast se nuk i’u përmbahen dispozitave të ligjit në fuqi sa i përket mbrojtjes së sinjalizuesve, njoftimit të tyre për të drejtat e tyre, mos caktimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim, mos ndërmarrjen e veprimeve pas raportimit të informacionit brenda afatit të përcaktuar dhe çështje të tjera. Për mos përmbushjen e këtyre obligimeve, ligji ka paraparë gjoba nga 500 deri në 20,000 euro.

Par. 3 i këtij neni parasheh se kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes për sektorin privat paraqitet nga Inspektorati i Punës (IP) në gjykatën kompetente. Pra IP e ka barrën për të iniciuar procedurat për kundërvajtje në rast të mos përmbushjes së obligimeve të këtij ligji nga ana e subjekteve të sektorit privat.

FOL përmes kërkesave për qasje në dokumente publike ka tentuar të marrë informacione në lidhje me numrin e procedurave për kundërvajtje të iniciuara nga ky institucion, si dhe nivelin e kapaciteteve njerëzore të IP-së për zbatimin e këtij ligji, mirëpo nuk ka arritur të marrë përgjigje.¹⁴ Gjithsesi, është fakt i njohur për qytetarët vite me radhë se IP përballet me një sërë vështirësish sa i përket mungesës së

¹² Neni 5 paragrafi (1) i Ligjit për Mbrojtjen e Denoncuesve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.196/15, 35/18 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.257/20).

¹³ Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Ligj nr. 60/2016 për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, neni 10.

¹⁴ FOL në lidhje me këtë ka dërguar ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, mirëpo e njëjta nuk ka arritur të marrë epilog deri në publikimin e këtij raporti.

kapaciteteve njerëzore për të mbuluar mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve që i ka në barrë në tërë territorin e Kosovës.

Sa i përket obligimit për raportim vjetor të rasteve të sinjalizimit nga ana e institucioneve të sektorit publik dhe privat dhe rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë, neni 29 i LMS-së thekson se:

- ***“Institucionet publike, subjektet private si dhe rregullatorët sipas fushës në të cilën bëhet sinjalizimi, përgatisin raport vjetor lidhur me sinjalizimin për vitin paraprak deri më 31 dhjetor.***

Raporti vjetor nga paragrafi 1 i këtij neni i paraqitet Agjencisë kundër Korrupsionit më së voni deri me 31 janar të vitit vijues.

Agjencia kundër Korrupsionit përgatit dhe publikon raport vjetor të përgjithshëm lidhur me sinjalizimin për vitin paraprak deri më 31 mars të vitit vijues.”

Ndërkaq në raportet vjetore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit figuron se gjatë vitit 2020, 2021 dhe 2022 janë paraqitur vetëm 5 raporte vjetore nga institucionet e sektorit privat. Ky numër tregon se vetëm një përqindje e vogël e numrit të bizneseve, nga totali prej 721 biznese me mbi 50 punëtor¹⁵ sa operojnë aktualisht në territorin e Kosovës, kanë vepruar konform obligimeve ligjore që i parasheh LMS. Kjo përveç se nga njëra anë mund të konsiderohet si mungesë e përgjegjësisë së sektorit privat për përmbushjen e obligimeve ligjore për raportim, nga ana tjetër mund të shihet si mungesë e informacionit të ekzistimit të këtij obligimi ligjor nga ana e bizneseve.

Në nenin 30 të LMS-së është përcaktuar afati për nxjerrjen e akteve nënligjore. Në par. 2 dhe 3 të këtij neni është përcaktuar se:

“Në afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, punëdhënësit sipas këtij ligji caktojnë zyrtarët përgjegjës për sinjalizim dhe e njoftojnë AKK-në për sektorin publik, përkatësisht Inspektoratin e Punës për sektorin privat.

Agjencia kundër Korrupsionit dhe Inspektorati i Punës, obligohen të fillojnë procedurat sipas ligjit për kundërvajtje ndaj punëdhënësve dhe zyrtarëve përgjegjës të cilët nuk i kane përmbushur obligimet sipas këtij ligji, jo më vonë se gjashtë (6) muaj.”

Rrjedhimisht, mund të konkludojmë se përgjegjësinë për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të LMS-së për sektorin privat e ka Inspektorati i Punës. Mirëpo, gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të këtij institucioni, si dhe në raportet vjetore të tij, LMS nuk figuron askund në listën e ligjeve për të cilat ky institucion e bën mbikëqyrjen apo inspektimin e zbatimit. Madje, fjala sinjalizim nuk përmendet fare në asnjë raport të këtij institucioni.

Në këtë kontekst, çështja e institucioneve kompetente ku duhet të bëhet sinjalizimi i jashtëm në sektorin privat, si dhe çështja e mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave të këtij ligji, janë thelbësore për vlerësimin e përgjegjësisë dhe efikasitetit të këtij ligji. Prandaj FOL vlerëson se është i nevojshëm një ri përcaktim i strukturave dhe institucioneve përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, duke përfshirë edhe përcaktimin në mënyrë të qartë dhe të përshtatshme të institucioneve ku duhet të bëhet raportimi.

¹⁵ Sipas informacioneve të pranuara nga Administrata Tatimore e Kosovës, në Kosovë aktualisht operojnë 121,829 biznese në total, nga të cilat 721 biznese janë me mbi 50 të punësuar.

7. KONKLUZION

Dispozitat ligjore që i referohen sinjalizimit në sektorin privat janë të paqarta dhe nuk ofrojnë koncizitet për qytetarët, përkatësisht për të punësuarit në sektorin privat. Kjo për shkak se ligji ka lënë vend për hamendësime për këta të punësuar në lidhje me atë se cilat janë institucionet kompetente për të sinjalizuar apo raportuar shkeljet dhe keqpërdorimet që ndodhin në ambientet e tyre të punës.

Duke marrë parasysh edhe përvojën tonë si Lëvizje FOL në fushatën ndërgjegjësuere për ngritjen e vetëdijes se punëtorëve mbi mundësitë e raportimit të shkeljeve dhe keqpërdorimeve me kompanitë kosovare anembanë vendit, mund të konstatojmë se ligjvënësi me zgjidhje të tilla legjislative nuk mund të arrijë qëllimin dhe natyrën e LMS-së.

Duke marrë parasysh atë që u theksua edhe në përmbajtjen e këtij raporti analitik, në vijim do të theksohen gjetjet kryesore të këtij raporti.

- Si institucione kompetente për raportim të jashtëm në sektorin privat, ligji i është referuar *“rregullatorëve sipas fushave të përgjegjësisë”*, duke nënkuptuar institucionet specifike varësisht nga lloji dhe natyra e rastit që raportohet. Mirëpo, ligji ka lënë boshllëk në identifikimin e këtyre institucioneve dhe në mungesë të një strukture të përcaktuar të raportimit, sinjalizuesit mund të kenë vështirësi në gjetjen e rrugës së duhur për të raportuar dhe për tu siguruar që çështjet e tyre të trajtohen në mënyrë efektive.

Prandaj për të garantuar funksionimin dhe zbatimin e këtij ligji në sektorin privat, është e domosdoshme që ligji të specifikoj autoritetet kompetente që janë përgjegjëse për të pranuar dhe shqyrtuar raportimet e sinjalizuesve.

- Neni 27 i LMS - së u'ka lënë në barrë subjekteve të sektorit privat që vet ta caktojnë procedurën e pranimin dhe trajtimin të rasteve të sinjalizimit përmes akteve nënligjore. Por ndryshe nga Ligji për Mbrojtjen e Denoncuesve i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ligji jonë nuk ka paraparë obligimin e ndonjë institucioni për të hartuar udhëzime mbi bazën e të cilave do të hartoheshin këto akte nënligjore.
- Përgjegjësinë për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave për sektorin privat e ka Inspektorati i Punës. Mirëpo, gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të këtij institucioni, si dhe në raportet vjetore të tij, LMS nuk figuron askund në listën e ligjeve për të cilat ky institucion e bën mbikëqyrjen apo inspektimin e zbatimit. Madje, fjala *“sinjalizim”* nuk përmendet fare në asnjë raport të këtij institucioni.
- Në anën tjetër, edhe Qeveria e Kosovës ishte vonuar në nxjerrjen e aktit nënligjor për procedurën e pranimin dhe trajtimin të rasteve të sinjalizimit. Dokumenti i cili duhej të nxirrej në korrik të vitit 2019, ishte miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës me 6 maj 2021, pra 1 vit e disa muaj me vonesë. Gjithashtu, me vonesë ishin nxjerrë edhe dy udhëzuesit tjerë: *për mbrojtjen që ju ofrohet personave që dorëzojnë raportimet në interes publik; për mënyrën e kryerjes së hetimit administrativ.*

- Raportet vjetore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit tregojnë se gjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022 vetëm 5 biznese nga totali prej 721 biznese me mbi 50 punëtor kanë paraqitur raporte vjetore mbi numrin e rasteve të sinjalizimit brenda vitit. Kjo tregon se vetëm një përqindje e vogël e subjekteve të sektorit privat kanë vepruar konform obligimeve të LMS-së për raportim, situatë e cila nënkupton se ky sektor nuk i përfill obligimet ligjore apo nuk është mjaftueshëm i informuar për kërkesat e ligjit.

Rrjedhimisht, kërkohet një respektim i klimës së përgjegjësisë dhe mbështetjes institucionale për të inkurajuar bizneset të respektojnë ligjin dhe të raportojnë rastet e sinjalizimit në përputhje me ligjin.

8. REKOMANDIME

Bazuar në përmbajtjen e këtij raporti analitik, në tekstin në vijim janë paraqitur rekomandimet e Lëvizjes FOL në lidhje me çështjen e sinjalizimit në sektorin privat. Përmbushja e këtyre rekomandimeve do të shërbente si pikënisje e fillimit të zbatimit të dispozitave të LMS-së në sektorin privat.

- 1. Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Drejtësisë, të bëjë vlerësimin ex-post të Ligjit për Mbrotjtjen e Sinjalizuesve për të vlerësuar efektivitetin e tij dhe për të shqyrtuar mundësitë për plotësim/ndryshimin e tij. Kjo e fundit me qëllim të specifikimit të autoriteteve kompetente që do të pranojnë dhe shqyrtojnë raportimet nga ana e subjekteve të sektorit privat, në mënyrë që të sigurohet implementimi i duhur i ligjit në praktikë.**
- 2. Në ndryshimet e mundshme të ligjit të përfshihen përfaqësuesit e bizneseve, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe palë të tjera. Kjo në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e të gjithë akterëve që mund të kontribuojnë në këtë drejtim.**
- 3. Të ri-përcaktohen institucionet kompetente për të pranuar, shqyrtuar dhe trajtuar sinjalizimin e jashtëm në sektorin privat, në mënyrë që të mos ketë hamendësime tek të punësuarit e sektorit privat se cilat janë këto institucione. Të shqyrtohet mundësia e transferimit të kësaj kompetence tek Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit. Kjo me qëllim të harmonizimit të standardeve të sinjalizimit për sektorin publik dhe privat.**
- 4. Të rritet numri i stafit profesional të Inspektoratit të Punës, në mënyrë që të fillojë mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji për sektorin privat, dhe të kryej obligimet për iniciimin e procedurave për kundërvajtje për subjektet që nuk i përmbushin obligimet e parapara me këtë ligj. Kjo do të kontribuonte në forcimin e aftësive të institucionit për të siguruar respektimin dhe zbatimin e Ligjit për Mbrotjtjen e Sinjalizuesve në sektorin privat, duke ndihmuar në parandalimin dhe ndëshkimin e shkeljeve në këtë kontekst.**

5. *Të parashihet obligimi për miratimin e udhëzimit administrativ mbi bazën e të cilit do të hartoheshin aktet e brendshme të institucioneve private për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit.*
6. *Të organizohen fushata ndërgjegjësuese për të punësuarit e sektorit privat në lidhje me obligimet që parashihen në LMS, si dhe për benefitet e zbatimit të këtij mekanizmi.*